



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE/A:	23/04/2018
REFERENC-Ë:	Zyrt. 04- 99
PËR/ZA/TO:	Ofertuesit e ekskursionit për maturanët e Gjmnazit "Asllan Berisha" në Rogovë
CC:	Gjmnazi "Asllan Berisha" në Rogovë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë
NGA/OD/FROM:	Komisioni selektues
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Njoftim

Njoftohen ofertuesit (agjensitë turistike) të licensuara, të cilat kanë marrur pjesë në ofertim për organizimin e ekskursionit të maturanëve të Gjmnazit "Asllan Berisha" në Gjakovë në Republikën e Shqipërisë, bazuar në ofertën e shpallur të dt.10/04/2018 dhe pas shqyrtimit të ofertave, Komisioni selektues ka marrur Vendim 04 Nr.98 të dt.23/04/2018.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 8 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Me respekt !



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 98

Më:23/04/2018

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 Për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, ofertën e dt.10/04/2018 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në Gjimnazin “Asllan Berisha” në Rogovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlora, Lezha, Tirana, Kruja, Apollonia, Berati, Shkodra dhe qyteti i ekskursionit. Ekskursioni zgjat 5 bujtje (pansion i plotë) prej datës 02/05/2018 deri me 07/05/2018.

Lista e konkurrentëve për të fituar ofertën për ekskursion të maturantëve të Gjimnazi “Asllan Berisha” në Rogovë:

1. “Bledi” me çmim 110.00 €;
2. “Miroci - Reisen ” me çmim 75.00 €;
3. “Mendi ” me çmim 100.00 €;
4. “Norway Travel” me çmim 95.00;

Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.18/04/2017 në ora 13:30 sipas ofertës i dt.10/04/2018 ku prezent ka qenë përfaqësueset e Drejtorisë së Arsimit znj.Flutur Këpuska, z.Sami Shala Sekretar i Gjimnazit “Asllan Berisha” në Rogovë, z.Agim Morina – Drejtor i Gjimnazit “Asllan Berisha” në Rogovë, znj.Afijete Boshnjaku Haxhikadrija – Zyrtar e Drejtorisë së Arsimit e ftuar në cilësi të vëzhguesit si dhe përfaqësuesit e kompanive konkurruese.

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

Firma transportuese “Bledi” ka konkuruar me çmim prej 110.00€ me pansion të plotë, vendosja në Hotel “Euro Drin”, drejtori dhe kujdestarët e klasave iu ofrohen shërbimet gratis. Posedon Certifikatën – Deklarues i TVSH-ës, Certifikatën e Numrit Fiskal, Certifikatën e Regjistrimit, posedon Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës. Ka prezantuar një (1) shofer së bashku me certifikatën shëndetësore, është prezantuar një (1) autobus, ka prezantuar licencën e punës dr.Atdhe Aziz Agaj së bashku me kontratën e tij të punës, si dhe një marrëveshje të qirasë me kompaninë “Bechtel Encha GP” të prezantuar si formë e referencës.

Firma transportuese “Miroci Reisen” ka konkuruar me çmim prej 75.00€ me pansion të plotë, vendosja në Hotel “Ballkan” në Durrës, drejtorit dhe kujdestarët e klasave iu ofrohen shërbimet gratis. Ka prezantuar kontratën me dr.Hasan Gjokokaj së bashku me licencën e tij të punës. Ka prezantuar Referencë nga Q.K.M.F e Deçanit, ka paraqitur autorizimin për kryerjen e procedurës së inspektimit të dt.24/02/2017 të lëshuar nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave – Autoriteti Kombëtar i Ushqimit – Drejtoria Rajonale Durrës me numër të protokollit 147/13, ka prezantuar Parakontratë në mes të “Hotel Ballkan” me adresë Shkëmbi i Kavajës – Durrës dhe “Miroci”. Ka prezantuar një (1) autobus, një (1) shofer së bashku me certifikatën shëndetësore. Posedon Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, ka prezantuar Certifikatën e Numrit Fiskal, Certifikatën e Regjistrimit.

Firma transportuese “Mendi” ka konkuruar me çmim prej 100.00€ me pansion të plotë, vendosja në Hotel “Skampa” në Durrës, drejtorit dhe kujdestarët e klasave iu ofrohen shërbimet gratis. Ka prezantuar një foto të autobusit, ka prezantuar kontratë mbi bashkëpunimin afarist “Mendi” dhe “Hotel Skampa” të kontraktuar me dt.12/04/2018, ka prezantuar Akt – Miratim Higjiëno-Sanitar nr.56 me numër regjistrimi 1671 i dt.05/09/2016 të lëshuar nga ana e Republikës së Shqipërisë – Minsitrisë së Shëndetësisë – Inspektorati Shtetëror Shëndetsëor – Dega Rajonale Qarku Tiranë, po ashtu ka prezantuar edhe fletëpalosjen e Hotel “Skampa”. Ka prezantuar Referencë nga ana e menaxherit të Gjimnazit “Asllan Berisha” në Rogovë. Ka prezantuar një (1) shoferë së bashku me certifikatën, ka prezantuar një (1) autobus, posedon Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës. Ka prezantuar diplomën e dr.Hasan Ahmetaj si dhe kontratën e prezantuar në mes dy palëve kontraktuese. Ka prezantuar Certifikatën e Regjistrimit, Certifikatën e Numrit Fiskal, Certifikatën – Deklarues i TVSH-ës.

Firma transportuese “Norway Travel” ka konkuruar me çmim prej 95.00€ me pansion të plotë, vendosja në Hotel Elba Premium SH.P.K Shkëmbi i Kavajës – Durrës. Ka prezantuar dy (2) foto të autobusit, 4 (katër) foto të hotelit në fjalë, po ashtu ka prezantuar Licencën e Punës dr.Selim Mehmeti si dhe kontratën në mes të dy palëve kontraktuese. Ka prezantuar Vërtetimin Tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës, Vërtetimin nga Komuna e Gjakovës për obligimet e tatimit në pronë. Ka prezantuar Kontratë Bashkëpunimi në mes të Hotel Elba dhe agjensionit turistik “Norway Travel”, Leje e Lëshuar nga Republika e Shqipërisë – Minsitria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes –Qendra Kombëtare e Licencimit, ka prezantuar Certifikatë Regjistrimi të personit të tatueshëm Elba Premium të lëshuar nga ana e Minsitrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, po ashtu edhe Akt – Miratim Higjiëno-Sanitar nr.3 të lëshuar nga ana e Republika e Shqipërisë – Minsitria e Shëndetësisë – Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë – Inspektorati Sanitar Shtetëror. Posedon Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, ka prezantuar Certifikatën e Regjistrimit, Certifikatën – Deklarues i TVSH-ës, ka prezantuar dy (2) shoferë së bashku me certifikatën e tij shëndetësore, ka prezantuar dy (2) autobusa, si dhe ka prezantuar dy referenca.

Vlerësimi i Komisionit selektues:

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, ku me ç`rast të njëjtit janë ftuar nga mësimdhënësit kujdestarë të klasave dhe takimi është mbajtur në secilën klasë veç e veç. Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisioni selektues me dt.18/04/2018 (e mërkure) ka hapur ofertat në fjalë.

Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Gjimnazin "Asllan Berisha" në Rogovë të përzgjedhet firma "Mendi" me çmim prej 100.00€

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike "**Mendi**" me çmim prej 100.00 €

Mendi nga Deçani

Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasëve të 12-ta (3 arsimtarë), Pëlqimit të Këshillit të Prindërve për secilën klasë veç e veç (për 3 klasë), listave për aprovimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e të gjithë nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion, Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Gjimnazin "Asllan Berisha" në Rogovë të përzgjedhet firma "**Mendi**" me çmim prej 100.00€, pasi firma në fjalë ka konkuruar me 5 (pesë) fjetje ashtu sipas ofertës të dt.10/04/2018. Po ashtu marrja e këtij Vendimi nga ana e Komisionit selektiv për shqyrtimin e ofertave të agjensive turistike bëhet me arsyetimin edhe sipas Pëlqimit të Këshillit të Mësimdhënësve të klasave të 12-ta të mbajtur me dt.20/04/2018, po ashtu edhe Pëlqimit nga ana e Këshillit të Prindërve të Gjimnazit "Asllan Berisha" në Rogovë për realizimin e ekskursionit të dt.20/04/2018.

Komisioni selektues:

1. Flutur Këpuska
(emri dhe mbiemri)

 dt.23/04/2018
(pozita)

2. Sami Shala
(emri dhe mbiemri)

 dt.23/04/2018
(pozita)

3. Agim Morina
(emri dhe mbiemri)

 dt.23/04/2018
(pozita)

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 8 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Agjencive turistike, Sektorit të Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë, Shërbimit juridik dhe Arkivit.